



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
Drejtoria e Inspeksionit
Drenas, më 06.02.2019



RAPORT PËR MUAJIN JANAR 2019

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçantë janë realizuar inspektime të subjekteve hoteliere rreth respektimit të Ligjit të duhanit si dhe inspektime të Operatorëve Ekonomik në zbatim të urdhërësive nga Ministria e Tregtisë për largimin nga shitja të artikujve që nuk i plotësojnë kriteret për treg. Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas sektorëve të tyre përkatës: Në vazhdim i keni punët e kryera nga secili sektor :

Sektori i Sanitarisë : Gjatë muajit janar me rëndësi të veçantë janë inspektuar subjektet hoteliere me qëllim të kontrollës së Ligjit të duhanit, duke vazhduar me masat ndëshkuese për shkelësit e Ligjit (persona fizik dhe persona përgjegjës të subjekteve), vërejtje dhe sugjerime për subjektet e reja dhe në përgjithësi është përmirësuar respektimi i Ligjit gjatë këtij muaji. Janë inspektuar edhe disa markete ushqimore që ushtrojnë veprimtarinë në kuadër të bizneseve-pompa të derivateve të naftës.

Pastaj janë inspektuar furrat e bukës në Drenas dhe Komoran për kushtet higjenike, është konstatuar një gjendje jo e mirë higjenike në disa prej tyre, ju është dhënë afat për përmirësim të këtyre parregullësive, është shqiptuar edhe gjobë mandatore në ato raste ku nuk janë përmirësuar kushtet dhe do të vazhdohet me inspektim të atyre që nuk kemi inspektuar deri më tani.

Është inspektuar edhe tregu javor në Drenas dhe Komoran rreth kushteve të mbajtjes së tregut, ndalimi i shitjes jashtë lokacionit të tregut dhe ndalimi i therrjes së gjedheve në tregun në Komoran. Për kushtet e krijuara nga mbeturinat në tregun në Drenas, janë marrë masat ndëshkuese ndaj Kompanisë KRM”Pastrimi” e cila gjendje është përmirësuar pas kësaj.

Gjatë këtij muaji kemi pasur tri kërkesa për pëlqim sanitar, dy nga to për subjekte shëndetsore private dhe një autoshkollë. Janë shqiptuar gjithsej 23 gjoba mandatore në vlerë (2450 €).

Sektori i Ndërtimit gjatë këtij muaji ka mbajtur në kontrollë dhe ka zhvilluar procedura për ndërtimet në objektet banesore në Drenas të cilat janë duke u shëndrruar në objekte afariste duke i mbajtur nën vëzhgim në bazë të procedurave. Janë realizuar procedura të kthimit të pronave komunës të cilat janë të uzurpuara. Është përgatitur lista e objekteve të ndërtuara pa leje për 2018.

Gjithashtu edhe këtë muaj ka qenë pjesë e Komisionit për shqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit Komunal për dhënien e tokës në shfrytëzim afat gjatë Bashkësisë Islame në Drenas.

Sektori i Komunikacionit në zbatim të Planit Operativ, kanë bërë inspektime rreth transportit të udhëtarëve me rëndësi të veçantë, kontrollë e operatorëve ilegal si dhe rendin e udhëtimit të operatorëve legal, ku gjatë këtij muaji janë shqiptuar 9 Gjjoba Mandatore në vlerë 100€ .

Inspektori i Tregut gjatë këtij muaji ka kontrolluar marketet dhe bizneset afariste në bazë të U.A Nr. 20/2018 Për caktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të flamurit mbi origjinën e produktit i ka obliguar për vendosjen e flamurit në produkt. Gjithashtu është angazhuar për përcjelljen e bizneseve tek zyra e regjistrimit të bizneseve në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik.

Inspektori i Ambientit ka kryer inspektime të mjedisit në shqyrtim të kërkesave të palës, me fokus në inspektimin e bizneseve në relacionin Drenas-Komoran rreth hyrjes së tyre në sistem të menaxhimit të mbeturinave.

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punes në shifra për muajin Janar 2019:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktvendime	Gjoba mandatore	Fletëparaqitje	Kërkesa për Pëlqim	Pëlqime Sanitare	Kërkesa	Shqyrtim i kerk.	Mbyllje të lokalev	Konfiskim i targave dhe automjeteve	Konfiskim i mallit Të dyshimtë
I.Sanitar	71	2	23	-	3	3	-	3	-	-	-
I.Tregut	27	1	-	-	3	-	3	3	3	-	-
I.komunikacionit	11	-	9	-	-	-	-	2	-	-	-
I.Ndërtimit	7	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
I.Ambientit	2	-	-	-	-	-	2	2	-	-	-
Totali	107	3	32	-	6	3	5	10	3	-	-

Shkurt, 2019